



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.DH.SH.II.nr.1476/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkallës së Dytë, me gjyqtaren Franciska Zhitija Ymeri në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit SE-FA Hurriyet Mh., me seli në Stamboll, Republika e Turqisë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Liman Musa, avokat nga Ferizaj, kundër debitorit “The North Unicorn” L.L.C., me seli në Prishtinë, Zona Industriale, rruga “Aziz Abrashi”, p.nr., përfaqësuar sipas autorizimit nga Arianit Koci dhe Grait Vokshi, avokat në Prishtinë duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.486/23 të datës 31.07.2023, me datën 24.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

APROVOHET e bazuar ankesa e debitorit “The North Unicorn” L.L.C., me seli në Prishtinë, dhe Anulohet aktvendimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr. 486/23 të datës 31.07.2023, dhe çështja kthehet në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr. 486/23 të datës 31.07.2023, e ka hedhur si të pasafatshëm prapësimin e debitorit “The North Unicorn” L.L.C., i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.213/22 të datës 21.04.2022, të lejuar nga Përmbaruesi Privat Besnik H.Aliu.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori për shkak të konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që gjykata e shkallës së dytë ta aprovoj ankesën si të bazuar, aktvendimin e shkallës së parë ta ndryshoj, debitorit në bazë të nenit 129 të Ligjit për Gjykatën Komerciale ti bëhet kthimi në gjendje të mëparshme duke vendosur sipas prapësimit duke e rivendosur edhe afatin e prapësimit si të afatshme.

Kreditori nuk ka ushtruar përgjigje në ankesë

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

Ankesa e debitorit është e bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori me datën 21.04.2022, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm Faturës Nr.SEF2020000001354 e datës 28.11.2020, me të cilin është urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të urdhrin, t'ia paguaj kreditorit shumë prej 250.00 €, me kamatë ligjore prej 8% nga data e lëshimit të faturës e deri në pagesën definitive, shpenzimet e procedurës përmbartimore, si dhe shpenzimet në emër të përpilimit të propozimit për përmbartim në lartësi prej 104.00 €. Përmbartimi të realizohet me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare në të gjitha bankat komerciale në Kosovë, dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e kreditorit, regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, deri në pagesën definitive.

Përmbartuesi Privat, Besnik H. Aliu, me seli në Ferizaj duke vepruar sipas propozimit të kreditorit ka lejuar urdhrin përmbartimor P.nr.213/2022, të datës 21.04.2022

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka paraqitur prapësim duke theksuar se propozimi për përmbartim është mbështetur në faturë në gjuhë të huaj e cila nuk është në asnjërën nga gjuhët zyrtare në Kosovë, e cila për debitorin është e pakuptueshme dhe se e njëjta nuk i plotëson kushtet ligjore sipas UA nr. 15/2010 për zbatimin e ligjit mbi administratën tatimore dhe procedurat, ngase nuk është e nënshkruar as e vulosur nga debitori. Më tej, ka shtuar se debitori ka kryer pagesa në vazhdimësi për kreditorin dhe atë në lartësi prej 5,000.00 € dhe sikurse fatura mbi bazën e së cilës është lejuar urdhri të jetë e vërtetë, përsëri nuk i plotëson kushtet ngase nuk mund të jetë në vlerën e kërkuar. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimi i debitorit të aprovohet si i bazuar, urdhri përmbartimor P.nr.213/2022 të shfuqizohet dhe të detyrohet kreditorit që debitorit t'ia paguaj shpenzimet në emër të prapësimit në lartësi prej 104.00 €, sipas tarifës së avokatëve. Kreditori, në përgjigje në prapësim ka kundërshtuar në tërësi thëniet e debitorit në prapësim si të pabazuara dhe të pambështetura në prova. Më tej, ka theksuar se kreditori ka kërkuar nga debitori përmbushjen e obligimit sipas faturës mirëpo që nuk ka hasur në mirëkuptim të debitorit dhe rrjedhimisht është detyruar që të inicioj procedurë përmbartimore. Ndërsa, në raport me pretendimet e debitorit për pagesat e kryera, kreditori ka theksuar se të njëjtat pagesa kanë të bëjnë me fatura tjera nga kjo mbi të cilën është iniciuar procedura përmbartimore. Ka shtuar se asnjëra nga kushtet për anulimin e urdhrin nuk ekzistojnë pasi që urdhri është nxjerr konform dispozitave të LPP-së, dhe se fatura mbi të cilën mbështetet propozimi për përmbartim i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që ta refuzoj si të pabazuar prapësimin e debitorit, ashtu që urdhri përmbartimor P.nr.213/22 të mbetet në fuqi, si dhe të detyrohet kreditori që debitorit t'ia paguaj shumën prej 208.00 €, në emër të paraqitjes së përgjigjes në prapësim.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, pas vlerësimit të prapësimit dhe përgjigjes në prapësim, ka nxjerrë aktvendim si të pasafatshëm për arsyet si në vijim: Sipas vlerësimit të Gjykatës se shkallës së parë, debitori Urdhrin Përmbartimor P.nr.213/2022 të datës 21.04.2022 të lejuar nga Përmbartuesi Privat Besnik H. Aliu, e ka pranuar me datë 27.04.2022, e cila vërtetohet nga fletë kthesa që gjendet në shkresat e lëndës, ndërsa prapësimi nga ana e debitorit është paraqitur me datë 05.05.2022.

Sipas dispozitës së nenit 70 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore përcaktohet se “Prapësimi duhet t'i paraqitet Gjykatës brenda shtatë (7) ditëve pas pranimit të vendimit përmbartues ose

urdhrit përmbarues”, ndërsa me nenin 126 par. 2 të LPK-së, përcaktohet se “ Në qoftë se afati është caktuar me ditë, përjashtohet nga llogaritja dita në të cilën ka filluar ngjarja ose koha nga e cila duhet të filloj afati, kështu që për fillim të afatit merret dita e parë e ardhshme.” Andaj, duke marrë parasysh faktin se në rastin konkret debitori Urdhrin Përmbarimor P.nr.213/2022 të datës 21.04.2022, e ka pranuar me datën 27.04.2022, ndërsa afati për paraqitjen e prapësimit ka filluar të rrjedhë nga data 28.04.2022, rezulton se dita e fundit për paraqitjen e prapësimit ka qenë data 04.05.2022. Meqenëse në rastin konkret debitori prapësimin e ka paraqitur me datën 05.05.2022, përmes komunikimit elektronik-email, ndërsa në shkresa të lëndës nuk ka prova se prapësimi është dorëzuar në ndonjërin nga mënyrat e tjera të përcaktuara për dërgimin e shkresave, rezulton se debitori prapësimin e ka paraqitur me 1 (një) ditë vonesë.

Dhoma e shkallës së dytë ka gjetur se aktvendimin e ankimuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 1 dhe 182 par 2 pika i), për arsye se palës nuk i është dhënë mundësia për shqyrtimin e çështjes në gjykatë. Në procedurën e zhvilluar pranë dhomës së shkallës së parë është paraqitur prapsimi i debitorit, dhe të cilin e ka hudhur prapësimin e debitorit si të pasafatshme, duke u bazuar në nenin 70 të LPP-së dhe nenin 126 par 2 të LPK-së, andaj me që kreditori me ankesë ka paraqit provë ku argumenton se prapësimin e ka dërguar me datën 04.05.2022 (ditë e Mërkurë) tek përmbaruesi privatë përmes postës elektronike, e që rezulton se kreditori ka paraqitë prapësimin në ditën e fundit të afatit prej 7 ditësh i cili është dhënë në këshillën juridike, andaj nga kjo rezulton se kreditori ka vepruar në përputhje të plotë me nenin 70 të LPP-së. Kështu, Përmbaruesi Privatë ka protokulluar si datë të dorëzimit të prapsimit 05.05.2022 dhe nuk ja ka bashkangjit shkresave të lëndës e-mailin e dorëzuar me prapësim nga kreditori, por tani me ankesë debitori ka provuar se prapësimin e ka dorëzuar me datën 04.05.2022, andaj, Dhoma e Shkallës së Parë është dashur të kërkoj që përmbaruesi privat ti dorëzoj të gjitha shkresat e lëndës, në mënyrë që ta vërtetoj se prapësimi a është dorëzuar në mënyrë fizike apo përmes postës elektronike, e më pas të vlerësoj afatshmërin e prapësimit.

Andaj, në ri procedurë, dhoma e shkallës së parë ti evitohet të metat e cekura, të vërtetoj faktet relevante, të zhvillojë procedurën përmbarimore në përputhje me dispozitat ligjore procedurale dhe pasi t'i vlerësojë dhe analizojë të gjitha provat e nevojshme, sipas vlerësimit të gjithanshëm të vendos drejt dhe sipas ligjit.

Nga të cekurat me lartë, e në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195, 208 dhe 209 par. 1 pika (d) e LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-DHOMA E SHKALLËS SË DYTË

K.Dh.Shk.II.nr.1476/23 me datën 24.04.2024

Gj y q t a r j a,
Franciska Zhitija Ymeri